URDHËR
Nr. 99, datë 10.2.2021

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT

(Ndryshuar me urdhrin nr. 137, datë 25.2.2021; nr. 209, datë 12.4.2021; nr. 99/1, datë 28.5.2021; nr. 99/2, datë 29.6.2021, nr. 373, datë 30.8.2021; nr. 397, datë 14.9.2021; nr. 373/1, datë 27.9.2021; nr. 373/2, datë 11.10.2021; nr. 397/2, datë 8.11.2021, nr. 373/3, datë 19.11.2021; nr. 527, datë 7.12.2021; nr. 373/4, datë 21.12.2021; nr. 373/5, datë 23.12.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, germa "d" të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809, datë 10.02.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 23:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 1.9.2021 deri në datën 4.1.2022.

1/1. Përjashtim, nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të urdhrit, bëhet vetëm për natën e ndërrimit të viteve, datë 31.12.2021–1.1.2022.

2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, bëhet për personat që duhet të lëvizin për emergjenca shëndetësore apo motive pune. Personat që lëvizin për arsye pune pajisen me autorizim përmes portalit e-Albania.

3. Punonjësit në sektorin e shëndetësisë dhe punonjësit e strukturave të shërbimeve kritike, përjashtohen nga rregulli i aplikimit në portalin e-Albania, duke patur dokumentacionin që vërteton punësimin pranë institucioneve.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid-19" i ndryshuar.

5. Çdo urdhër i mëparshëm në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu